



**AKT THEMELIMI**  
**PËR SHOQËRINE TREGTARE "AVANCE" SH.P.K.**  
**ME SELI NE TIRANE**

Sot, më datë 10. 07.2005, Ortakët Themelues:

1. Z. Nikolin Frrok JAKA, lindur në Mirditë, më 17 Maj 1972, banues në Tiranë, Rruga Labinoti, nr.123/1 me nr. Pasaporte Z1016214; madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar
2. Z.nja Alma Riza Tafani, lindur në Elbasan, e banuese në Tiranë, Rruga "Ded Gjon Luli", Pall.1; me nr. Pasaporte Z0189531; madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

te cilet me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur nëpërmjet këtij akti themelimi ranë dakord për krijimin e Shoqërisë Tregëtare "AVANCE" Sh.p.k. me kushtet e mëposhtme:

**NENI 1.**

Shoqëria Tregëtare "AVANCE" Sh.p.k themelohet si Shoqëri Tregtare, bazuar në ligjin Nr.7638, datë 9.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Ajo është Person Juridik Privat Shqiptar.

Selia e saj ndodhet në Qytetin e Tiranës me adresë: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kull 1, Zyra 7/1.

**NENI 2.**

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në normat e këtij Akti Themelimi, Statutit të Shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Themeluesit e saj mbajnë përgjegjësi vetëm për detyrimet që krijon Shoqëria dhe brënda vlerës së kapitalit themeltar.

**NENI 3.**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 100. 000 (Njëqindëmijë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga Ortaket Themelues Nikolin JAKA dhe Alma TAFANI në gjithë madhësinë e tij dhe në masën 100 % të vlerës së kapitalit themeltar.



Vlerësimi kapitalit themeltar eshte bere nga Ortaku Themelues me rastin e miratimit te ketij Akti Themelimi dhe eshte nenshkruar prej tij.

Vlerësimi i metejsheem i kapitalit themeltar nuk lejohet.

#### **NENI 4.**

Shoqeria ka te depozituar prane noteres Elsa Sina me seli ne Tirane, kapitalin ne te holla, ne daten e nenshkrimit te ketij Akti Themelimi.

Mbas regjistrimit te Shoqerise kjo shume do te kaloje ne llogarine e kesaj Shoqerie qe do te çelet prane njeres prej Bankave ne Tirane.

#### **NENI 5.**

##### **Objekti i Veprimtarise se shoqerise.**

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

1. Organizimin dhe zbatimin ne fushen e restoranteve kolektive dhe tregtare per entet publike dhe private.
  - a. Realizimin dhe drejtimin e dhenies se ushqimit te semureve dhe personelit spitalor, shtepive te mjekimit privat, kopshteve dhe çerdheve per femije, shkollave, universiteteve, akademive, sistemit te burgjeve, forcave ushtarake, dhe forcave te rendit, etj..
  - b. Realizimin dhe drejtimin e menceve, restoranteve, fast-food, bareve, kafeneve, pastiçerive, supermarketeve, etj.
  - c. Realizimin dhe drejtimin e hoteleve, kampingjeve, fshatrave turistike dhe ne pergjithesi sherbimeve publike dhe aktiviteteve te ngjashme.
  - d. Tregtimin me shumice e pakice dhe import eksport te paisjeve dhe mallrave qe kane te bejne me sektorin e aktivitetit te ushqimit dhe sherbimit.
  - e. Prodhim dhe shitje produktesh ushqimore, ngritje e impianteve dhe kombineve qe nevojiten per prodhimin e ketyre mallrave.
2. Tregtimin me shumice dhe pakice dhe import eksport te:
  - Mallrave industriale, ushqimore, lendeve te para, pije, veshmbathje, e konfeksione, hidrosanitare, elektrike, kancelari per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike, elektronike, kinkalери, elektro-shtepiake.
  - Produkte bujqesore e blektorale, fruta-perime, produkte deti, bime medicinale eterovajore e mjeksore, prodhime kozmetike dhe estetike, kimike dhe detergjente.
3. Transport
  - mallrash per vehte dhe per te trete brenda dhe jashte vendit.
  - udhetaresh brenda dhe jashte vendit me linje tokesore, detare dhe ajrore.
4. Financimin dhe realizimin e ndertimeve per ente publike dhe private per qellimi banimi, me karakter social, kulturor, industrial, vepra arti, ndertim dhe asfaltim rruges, ndertime urash, tunele e kanalizime; ndertime aeroportesh. Prodhime dhe shitje materiale ndertimi, ngritjen e impianteve dhe fabrikave qe nevojiten per prodhimin e tyre.





5. Projektme, studime e zbatime ne fushen energjitike, ne fushen e gazit dhe te ujit per entet publike dhe private.
6. Ngritjen dhe realizimin e sherbimit spitalor privat.
7. Ngritjen e agjensive imobiljare, agjensive turistike, zyra juridike dhe psikologjike, zyra kontabiliteti dhe asistence ne fushen fiskale dhe tregtare.
8. Sherbime ne fushen e pastrimit te ambjenteve te brendshme e te jashtme, gjelberimit dhe mirembajtjes per ente publike e private.
9. Sherbime ne fushen e lavanderise per ente publike e private.

#### **NENI 6.**

Shoqeria do te funksionoje me nje afat kohor mbi 10 vjet. Afati i fillimit te veprimtarise fillon mbas regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar. Aktiviteti i shoqerise mund te nderpritet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve

#### **NENI 7.**

Ortaket themelues mund te heqin dore nga Shoqeria por gjithnje per shkaqe te perligjura. Heqja dore nuk e shkarkon ortakun, nga detyrimet e Shoqerise deri ne momentin e heqjes dore.

#### **NENI 8.**

Investimet dhe veprimtaria e Shoqerise gezojne mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon te njejtat kushte si per subjektet shqiptare ashtu edhe ato te huaja.

#### **NENI 9.**

Fitimi i realizuar kalon ne pronesi te ortakeve themelues, ne perputhje me pjesemarrjen e ortakeve ne kapitalin themeltar.

Fitimi eshte lirisht i transferueshem brenda edhe jashte shtetit shqiptar.

#### **NENI 10**

Ortaket Themelues kane sidomos keto detyrime:

- Te regjistroje Shoqerine ne Rregjistrin Tregtar dhe te marri lejen e ushtrimit te aktivitetit te veprimtarise se tyre.
- Te derdhe kapitalin e nevojshem per fillimin e aktivitetit te Shoqerise.
- Te siguroje mjediset e nevojshme per fillimin e aktivitetit, makinerite, lendet e para e ndihmese.
- Te siguroje mundesite e specializimit te fuqise punetore dhe specialisteve per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise.
- Te siguroje objektet dhe makinerite e Shoqerise nga cdo lloj demtimi.
- Te menaxhoje prodhimin e ta reklamojne ate nepermjet mjeteve te ndryshme te informacionit.

#### **NENI 11.**

Organet drejtuese te Shoqerise jane :

- Asambleja e Ortakeve.
- Administratori.
- Ekspertet Kontabel.

Menyra e veprimtarise se tyre eshte percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

**NENI 12.**

Ortaket detyrohen te ruajne sekretin e themelimit dhe te veprimtarise se Shoqerise.

Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhedemtoje Shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.

**NENI 13.**

Ortaket mund te vendose me vullnetin e tyre, per pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera dhe te krijojne çdo lloj aktiviteti tjetër privat.

**NENI 14.**

Mosmarrveshjet per themelimin e Shoqerise zgjidhen nga vete Ortaket themelues te Shoqerise midis tyre me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

**NENI 15.**

Akti i Themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u nenshkrua prej tyre pa verejtje para Noterit te vendit te themelimit te Shoqerise.

**ORTAKET THEMELUES**

Nikolin

JAKA



Alma

TAFANI

